

Historia e shqiptarëve është e rrethuar me tragjedi

Robert Elsi (1950) është njëri nga albanologët e jashtëm bashkëkohës, radhët e të cilëve janë gjithnjë më të shumta, që studimit dhe prezentimit të kulturës dhe të letërsisë shqiptare i ka hyrë me një entuziazëm e përkushtim të rrallë. Përveç Leksikonit të Shkrimtarëve Shqiptarë (anglisht), ka bërë dy antologji të poezisë shqiptare (njërën gjermanisht, tjetrën është duke e përgatitur anglisht), ka përkthyer Migjenin gjermanisht dhe ka shkruar një sërë recensionesh për librat e autorëve shqiptarë dhe artikuj e studime të tjera nga letërsia e gjuhësia shqiptare.

Elsi është një anglez nga Vankuveri i Kanadasë. Atje edhe i ka bërë studimet, të cilat i ka vazhduar e shumëfishuar në universitete të tjera të ndryshme, si në Paris, në Berlin etj. Është doktoruar në fushë të gjuhësisë krahasimtare në Universitetin e Bonit (1978), ku kryen punën e lektorit. Po ashtu është interpret në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë.

Bisedën me Dr. Robert Elsin e bëmë në Prishtinë para disa kohësh, ku ishte pjesëmarrës në simpoziumin shkencor “Evropa dhe shqiptarët dje e sot.” Të shtojmë se gjatë këtij qëndrimi Elsi u pranua anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

[ShB]: Si zuri fill interesimi Juaj për albanologjinë?

[RE]: Shumë shkencëtarë gjermanë janë marrë me studimet albanologjike, sa mund të themi se studimet albanologjike janë themeluar në Gjermani me Hanin, që pati bërë një libër themelor në këtë fushë (“Studime shqiptare” 1854). Kjo nuk është një gjë e veçantë sepse Gjermania deri në periudhën midis dy luftave ishte një vend udhëheqës në studimet shkencore në çdo fushë.

Në kohë të fundit interesimi ka rënë dukshëm për shkak të izolimit të Shqipërisë sepse studiuesit nuk kishin mundësi të depërtojnë atje. Pastaj shihej një mungesë e madhe e librave që sherbejnë për këtë qëllim. Pasojë e asaj politike ishte dëmtimi i studimeve gjermane dhe të tjera sa sot Shqipëria ka mbetur një vend i panjohur për shkencën bashkëkohëse. Kjo nuk ndodhi me vendet e tjera të Ballkanit, kurse ata që merren me studimet shqiptare mbetën të paktë.

Duke e parë këtë zbrastësi, më ka lindur ideja të studioj e të hulumtoj në këtë fushë. Ishte në fillim mjaft e vështirë, sepse para 15 vjetësh kur edhe fillova, nuk kisha asnjë mundësi të takohesha me shqiptarët. Gjuhën e mësova përmes emisioneve të radios dhe librave në mënyrë pasive vetëm sa të marr vesh e të mund të lexoj. Fillim të vërtetë mund të marr vitin 1978 kur qeshë së pari në Shqipëri me një grup nga Universiteti i Bonit. Ishim të ftuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Shqipërisë. Më bëri përshtypje fakti që një kulturë evropiane kishte mbetur jashtë fokusit të interesimit të botës evropiane për shkaqe thjesht ideologjike.

[ShB]: A vërehen farë ndryshimesh në këtë drejtim kohëve të fundit?

[RE]: Para pak kohe është themeluar Shoqata Ndërkombëtare për Studimet Albanologjike nga Dr Ardian Klosi në Tiranë. Shpresoj se kjo Shoqatë do të ngrejë interesimin për studimet albanologjike në nivel ndërkombëtar.

Pasoja e izolimit të Shqipërisë është niveli i shkencës shqiptare e cila është shkëputur nga rrjedhat e shkencës evropiane. Po të shikoni Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, do të shihni se aty nuk gjenden shumë libra e material të tjera, madje edhe të periudhes së Luftë së Dytë Botërore.

Në këtë fazë duhet të bëhen më të dendura shkëmbimet e kontaktëve dhe veprimtaria intensive në fushë të përkthimit. Dihet se një kulturë njihet nëpërmjet përkthimeve. Mund të themi se sot ka shumë njerëz në Evropë dhe në Amerikë që interesohen për Shqipërinë, por gjuha është një pengesë. Duhet krijuar një brez përkthyesish jo vetëm për letërsinë, por edhe për shkencën shqiptare. Përkthimet që janë bërë deri tash nuk janë të lexueshme.

[ShB]: Formimi Juaj shkencor ka vënë nga gjuhësia, kurse kohëve të fundit merreni intensivisht edhe me letërsinë shqiptare. Përse e keni bërë këtë ripërcaktim?

[RE]: Kohëve të fundit merrem më shumë me letërsinë shqiptare dhe me përkthime. Gjuhësinë e kam lënë pak mënjane sepse ka edhe studiues të tjerë që merren më shumë me të, por nuk ka asnjë që merret me kulturën shqiptare, me letërsinë shqiptare etj. Kam dashur të plotësoj këtë zbrastësi, ku ndihet më shumë nevoja.

Unë kam bërë studimet në gjuhësinë krahasimtare indoevropiane në Universitetin e Bonit. Gjuha shqipe si një gjuhë indoevropiane me rrënjë shumë të lashta është një pjesë e interesimeve shkencore të gjuhëtarëve indoevropianë. Megjithatë gjuha shqipe përmban një problem të veçantë për studimet krahasimtare.

[ShB]: Përqëndrimi juaj te studimi i kulturës dhe i letërsisë shqiptare është çështje e kureshtjes për shkak të asaj zbrastësie apo lidhet me vlerat e caktuara?

[RE]: Në fillim ishte një kureshtje, sepse nuk isha në gjendje t'i vlerësoja cilësitë që ka letërsia shqiptare. Letërsia shqiptare si çdo letërsi evropiane ka cilësi të dalluara, por ka edhe mungesa të caktuara, ka pjesë të mira dhe pjesa të dobëta.

Kohëve të fundit merrem veçanërisht me letërsinë e sotme, si shprehje e kulturës shqiptare të ditëve të sotme në Shqipëri dhe në Kosovë. Prandaj me një gjë e tillë është më urgjente që të tregohet se ç'loj kulture kanë shqiptarët.

Ka pasur shumë shkrimtarë shqiptarë me shumë talent që nuk kanë pasur asnjë mundësi të botojnë veprat e tyre. Si pasojë, shkrimtarët më të mëdhenj kanë punuar si përkthyes. Si në çdo vend socialist edhe në Shqipëri njerëzit më të talentuar kanë punuar si përkthyes, ose kanë hartuar libra për fëmijë, duke kërkuar “një vend më të sigurt!”

[Shb]: A do të mund të përmendej edhe ndonjë emër?

[RE]: Ka një intelektual shumë të përmendur në rrethet kulturore të Tiranës: Petro Zheji, i cili është i njohur si një baba intelektual i një brezi të tërë shkrimtarësh, ndër të cilët bën pjesë edhe Ismail Kadare. Petro Zheji nuk ka pasur mundësi të botojë asnjë libër të tij. Ka bërë përkthime brilante: Aragoni, Servantesi, Asturias etj. Por si shkrimtar nuk i është kushtuar kurrfarë rëndësie. Nuk është kurrfarë anekdote po të them se fillimi i artit të përkthimit pas Luftës në Shqipëri e ka zanafillën në Burgun e Tiranës, pra burgu është shndërruar në zyra të përkthyesve më të mirë të një kulture! Atje kanë punuar Jusuf Vrioni, Petro Marko, Andrea Varfi, Lazër Radi (një shkrimtar i lindur në Prizren, i cili ka kaluar 46 vjet në burg dhe në internim) dhe shumë shkrimtarë e përkthyes të tjerë.

[ShB]: Diçka e ngjashme ndodhi edhe në Kosovë, sadoqë ka shpjegime të tjera, shkaqe të tjera.

[RE]: Faktikisht e njëjta gjë ka ndodhur edhe në Kosovë. Është e qartë se ka shpjegime të tjera. Nuk e kemi historinë e letërsisë së Kosovës, prandaj burimet e letërsisë së Kosovës janë pak të njohura. Brezi i dytë i shkrimtarëve të pasluftës të Kosovës u zhduk tamam si në Shqipëri. Ky është brezi i shkrimtarëve të viteve '50 dhe '60: Adem Demaçi, Martin Camaj, Agim Gjakova, Kapllan Resuli, Anton Pashku, Azem Shkreli, Ramadan Rexhepi, Teki Dërvishi, që erdhën pas brezit të Esad Mekulit e Hivzi Sulejmanit. Nga këta tetë shkrimtarë, Demaçi e Dërvishi u futën në burg, Gjakova e Resuli shkuan në Shqipëri (ky i fundit edhe atje u fut në burg), kurse Camaj e Rexhepi shkuan në Perëndim. Sadoqë arsyet ishin të ndryshme, realiteti ishte po ai. Pasojë e persekutimit të këtij brezi ka qenë rënia e nivelit të letërsisë shqiptare të Kosovës deri në vitet '70 e ca.

[ShB]: Pasojën e një persekutimi të tillë këtu e barti dhe vazhdon të bartë sidomos proza shqiptare. Nga gjiri i saj u rrëmbyen autorët më të mirë që kishte, madhe edhe ata që mbetën të krijojnë nuk shkuan shumë larg nga gjendja në të cilën ishin në momentin e asaj shprishjeje. Pra, pasojat e kësaj katastrofe janë të ndjeshme ende në prozë, kurse poezia sikur kaloi me mirë.

[RE]: Jam dakord. Historia e sotme është e rrethuar nga tragjedia. Tragjedia e një brezi shkrimtarësh u bë tragjedi e një letërsie të viteve '50 e '60 në Shqipëri, kur u krijua një vakuum i plotë kulturor. Domethënë fillimet që ishin bërë në vitet '30 u shkatërruan me vetëdije të plotë për hir të një ideologjie, për hir të një eksperimenti që tani shikohet si një gabim. Historia e letërsisë së sotme shqiptare ka kaluar nëpër valë të ndryshme. Në njërin anë ishin përpjekjet e shkrimtarëve për të arritur një nivel, për të shkruar lirisht, kurse në anën tjetër ishin valët e persekutimeve nga ana e shtetit. Janë të dhembshme ngjarjet e viteve '70, kur u zhvillua lufta e ashtuquajtur kundër liberalizimit, kundër ndikimit të ideologjisë së huaj. Kjo valë ka shkatërruar një brez tjetër. Gati çdo shkrimtar shqiptar i ka përjetuar këto tronditje, qoftë duke u ndaluar qoftë duke u internuar, qoftë duke u burgosur. Vetëm në vitet '80 u kapërcye kjo frikë. Domethënë, letërsia e sotme shqiptare shkruhet që dy-tri vite!

[ShB]: Ju keni një përvojë të mirë edhe në punë të hartimit të antologjive të poezisë shqiptare, që paraqet një aspekt plotësues të interesimit tuaj për letërsinë tonë. Ç'mund të na thoni për këtë përvojë tuajën?

[RE]: E thashë edhe më parë se qëllimi im është të bëj një prezentim sa më të plotë të letërsisë shqiptare, prandaj këtë e kam pasur parasysh edhe te antologjitë. Kështu në Antologjinë e Poezisë Shqiptare të përkthyer gjermanisht përfshihet poezia shqiptare që nga Matrënga deri më sot, pra atë prodhim poetik të krijuar në Shqipëri, në Kosovë dhe ndër Arbëreshët. Antologjia që kam bërë në anglisht dhe që s'e kam botuar ende është një antologji e poezisë së sotme, ose antologji e poezisë moderne shqiptare, që fillon me Lasgush Poradecin e me Migjenin. Për mendimin tim këta dy poetë janë lajmëtarët e poezisë moderne shqiptare.

[ShB]: Jemi në dijeni se i keni hyrë punës në një projekt mjaft serioz për hartimin e një historie të letërsisë shqiptare. A mund të na thoni diçka për të dhe për problemet me të cilat ballafaqoheni?

[RE]: Jam shumë i zënë me punën për të shkruar një histori të letërsisë shqiptare. Problemet me të cilat ballafaqohem në këtë punë nuk ndryshojnë shumë nga ato të studiuesve shqiptarë. Pikësëpari mungojnë librat. Shkencëtarët shqiptarë flasin shumë për autorë të shumtë, por askush nuk ka libra. Ka libra autorësh të ndryshëm që janë botime tepër të rralla. Mund të themi se çdo libër shqip i botuar para Luftës së Dytë Botërore ka vlerë si një libër i botuar gjermanisht në shekullin XVIII. Ky fakt vetëm pjesërisht lidhet me shkaqet ideologjike. Natyrisht që veprat e autorëve të ndaluar u zhdukën, por duhet pasur parasysh se botimet e paraluftës kanë qenë të rralla dhe kishte shumë pak lexues. Domethënë rrethi i lexuesve ishte shumë i kufizuar, prandaj nuk kanë mbetur shumë libra. Këtë rrethanë duhet parë të lidhur me peripecitë e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht pastaj me "diktaturën e proletariatit" kur u zhdukën shumë libra. Megjithatë kam shpresë se shumë vepra do të rikthehen. Edhe gjatë diktaturës, njerëzit do t'i kenë ruajtur të fshehur, madje edhe nën tokë. Dhe s'ka dyshim se një ditë do t'i nxjerrin prej andej si gjëra të shenjta.

[ShB]: Ballafaqimin me probleme të tilla në një mënyrë më konkrete do ta keni bërë gjatë hartimit të Leksikonit të Shkrimtarëve Shqiptarë, ku edhe i keni parë më hollësisht të gjitha këto për të cilat ankoheni?

[RE]: Leksikoni i Shkrimtarëve Shqiptarë është botuar në Nju-Jork para disa vjetësh. Është e vërtetë se jam ballafaquar me shumë probleme gjatë asaj pune për arsye se ishte një vepër themelore, që nuk ishte bërë më parë. Më gëzon fakti që Hasan Hasani tani ka përfunduar një vepër të tillë shumë më të plotë dhe uroj që të botohet sa më shpejt. Në bazë të këtij Leksikoni do të kemi të dhëna shumë më të sakta për shkrimtarët shqiptarë, sidomos për ata që njihen pak. Është një brez i tërë shkrimtarësh shqiptarë që janë zhdukur në Shqipëri në periudhën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Për shumicën prej atyre autorëve nuk dimë asgjë. Për shembull, para pak kohe u botua në Prishtinë "Dy tragjedi" të Et'hem Haxhiademit, i cili është një dramaturg shumë i rëndësishëm për historinë e dramaturgjisë dhe të teatrit shqiptar, por askush nuk di se kur dhe ku vdiq!

Haxhiademi u zhduk! Kjo është një ngjarje që nuk ka ndodhur para 500 vjetësh, por para më pak se 50 vjetësh! Ka shumë këso problemesh.

Në bazë të materialeve që kam mbledhur për Leksikonin kam filluar të shkruaj një Histori të Letërsisë Shqiptare, në të cilën punë jam angazhuar që 10 vjet. Ka dy vite që i kam hyrë sistematikisht në këtë projekt. Materialet i kam kompjuterizuar dhe po punoj për ta kryer në mënyrë sa më të plotë këtë veper, e cila do të botohet në gjuhën angleze. Mund të them se 80 përqind e kam kryer, kurse tani situata e re ka bërë që të më ndihmojnë në mënyrë shumë më efikase shkrimtarët shqiptarë nga Prishtina, por edhe ata nga Tirana. Ky është një rast i vetëm në të cilin prezentimi i letërsisë shqiptare bëhet në mënyrë të plotë. Domethënë, jo vetëm letërsia e Shqipërisë, jo vetëm letërsia e Kosovës, jo vetëm letërsia e realizmit socialist, por gjithë letërsia shqiptare.

[ShB]: Do të na interesonte të na thoni diçka për përvojën tuaj dhe sidomos për konceptin e kësaj historie të letërsisë shqiptare.

[RE]: Për fat të keq ndoshta të huajt kanë bërë më shumë se vetë shqiptarët në këtë fushë që nga fillimi. Historinë e parë të letërsisë shqipe ishte shkruar në gjuhën italiane nga Alberto Stratikoi në shekullin e kaluar, kurse tekstin më të mirë në këtë fushë e ka shkruar Gaetano Petrota “Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare” (Palermo 1931). Do të veçoja edhe atë të Skiroit të Ri, pastaj edhe një varg tekstesh të tjera, siç është edhe ai “Shkrimtarët Shqiptarë” i Gurakuqit/Koliqit, që është më shumë një antologji se sa një histori e letërsisë. Në dy tekstet e historisë së letërsisë shqipe të hartuara nga Akademia e Shkencave, nga të cilat i dyti është hartuar më 1983, ka mungesa të mëdha. P. sh. në këtë të vitit '83 mund të themi që është vetëm një çerek i letërsisë shqiptare: nuk përfshihet letërsia e Kosovës, gjysma e letërsisë së Shqipërisë dhe aspak ajo e diasporës. Dhe autorët janë prezentuar në një mënyrë të falsifikuar. Kjo nuk është bërë vetëm me periudhën e sotme, por që nga fillimi. Me një fjalë, Historia e Letërsisë Shqipe të vitit 1983 është një mashtrim dhe një krim kundër kulturës shqiptare. Këto fjalë janë një akuzë tepër të rëndë nga ana ime, por më duket se e ardhmja do të tregojë se kam të drejtë.

Përpjekja ime në këtë fushë do të përqendrohet në punën që të tregoj se si është zhvilluar historia e letërsisë shqiptare pa asnjë kufizim ideologjik, pa asnjë pretendim që të drejtoj letërsinë shqiptare në një drejtim ose në një drejtim tjetër, por vetëm ta prezentoj si është dhe si ka qenë, pra si është zhvilluar. Unë nuk dua të vlerësoj, të përcaktoj vendet e autorëve dhe vlerat e tyre. Ja, për shembull, poeti Gjergj Fishta, para Luftës ka qenë shpallur poet kombëtar shqiptar, kurse pas Luftës është cilësuar si poet klerik-fashist. Janë dy vlerësime krejtësisht ekstreme. Është mjaft vështirë të bëhet tani një vlerësim krejtësisht objektiv jo vetëm për Fishtën, por edhe për shumë shkrimtarë të tjerë të periudhave të ndryshme. Do të merrja edhe një shembull tjetër: Lasgush Poradecin. Dihet se Lasgushi është një nga poetët më të mëdhenj të letërsisë shqiptare të shekullit XX, kurse në Historinë e Letërsisë Shqiptare luan një rol shumë sporadik. Pse ndodh kështu? Sepse Lasgush Poradeci ka refuzuar të pranojë realizmin socialist, sa edhe ka thënë: “Më mirë të thyej lapsin sesa të shkruaj si duan ata!” Dhe pothuaj nuk ka shkruar më pas Luftës. Për një kohë të gjatë nuk ka pasur mundësi as të botojë. I është kthyer përkthimit.

UP TO HERE

[ShB]: Herë pas here keni shkruar edhe recensione të ndryshme për libra të veçantë të shkrimtarëve shqiptarë...

[RE]: Unë ndjek zhvillimin e kulturës dhe të letërsisë shqiptare me shumë vëmendje. Në recensionet që kam bërë deri tash jam përpjekur të prezantoj letërsinë shqiptare dhe jo ta interpretoj atë. Në këtë aspekt po ashtu kam bërë përpjekje të prezantoj disa nga botimet më të spikatura të kësaj letërsie para publikut ndërkombëtar. Këtë e kam bërë në revistën e Universitetit të Oklahomës "Letërsia Botërore Sot" (*World Literature Today*) e cila boton recensione për libra e çdo letërsie që krijohet sot që nga letërsia kineze deri te ajo argjentinase. Në recensionet e mia të deritashme kam marrë në shqyrtim libra të poezisë, të prozës e të kritikës letrare nga Tirana e nga Prishtina. Në këtë mënyrë do të vazhdoj edhe më tutje. Këtë punë e bëj ndërmjet punëve të tjera, disi në mënyrë sporadike, kur më gjendet ndonjë libër më afër vetës.

[ShB]: Jo morët pjesë në simpoziumin shkencor "Evropa dhe shqiptarët, dje e sot." Më shumë se për vetë simpoziumin do të na interesonte mendimi Juaj për raportin ndërmjet shqiptarëve dhe Evropës aktualisht.

[RE]: Për botën shqiptare ka ndodhur një absurditet. Absurditeti është që Shqipëria u izolua për një kohë të gjatë, kurse shqiptarët e Kosovës jetuan në një Jugosllavi gati gjysmëperëndimore përsa i përket hapjes ndaj botës. Kohëve të fundit Shqipëria u hap, me gjithë problemet që ka tani, të cilat janë shumë të rënda, kurse Kosova u mbyll nga shteti serb. Po të vazhdoj ky zhvillim, Shqipëria do të jetë e hapur sikundër që ishte Kosova në vitet '70, kurse Kosova do të jetë e mbyllur siç ishte Shqipëria nën diktaturën e Enver Hoxhës. Unë e shoh fillimin e një zhvillimi të tillë. Gjurmët janë të qarta. Prerja e mjetëve të komunikimit, qoftë të transportit, të telekomunikacionit apo të lidhjeve të tjera të Kosovës me Evropën bëhet në mënyrë të vrazhdë nga ana e Beogradit.

[ShB]: E vërtetë për shqiptarët dhe për Kosovën tash ka depërtuar në mënyrë më autentike në Evropë dhe në botë, prandaj edhe është ndryshuar pozicioni i vështrimit të kësaj çështjeje. Si e shihni ju këtë fenomen të ri të raportit ndërmjet shqiptarëve dhe Evropës?

[RE]: Ka pasur ca ndryshime kohëve të fundit, po nuk jam dakord se ai ndryshim është bërë plotësisht. Ai ndryshim është duke u bërë. Para ca kohësh problemi i Kosovës ishte krejtësisht i panjohur. Tani problemi i Kosovës po bëhet i njohur. Pra ende nuk është i njohur siç duhet. Asnjë njeri në Evropën Perëndimore ose në Amerikë nuk mund të përfytyrojë gjendjen e popullit shqiptar, që mund të krahasohet me gjendjen e popullit polak nën sundimin e Gjermanisë naziste, ose me gjendjen e çifutëve në Gjermani me vitet 30. Kjo është një gjendje katastrofike. Këtë them pasi që unë e njoh këtë gjendje, për arsye se kam qenë gati çdo vit në Kosovë kohëve të fundit. Me të vërtetë jam shumë i tronditur. Po të mos isha ballafaquar drejtpërdrejt me njohjen e kësaj gjendjeje, nuk do të besoja kurrë se mund të krijohet një situatë kaq ekstreme, kaq e pabesueshme siç është tash kjo në Kosovë.

[ShB]: A keni ndonjë përshtypje të veçantë nga qëndrimi juaj në Kosovë këto ditë?

[RE]: Kam shumë përshtypje për gjëra që vështirë edhe mund të besohen. Po të flas për ndonjërin prej tyre, në Gjermani për shembull, nuk do të gjendej ndonjë njeri që do të mund të më besonte po t'u flisja njerëzve për këto që ndodhin tash në Kosovë si për ngjarjet të shekujve V apo XVIII. Gjëra të tilla në fund të shekullit XX nuk konceptohen.

Sipas mendimit tim përpjekje e parë e të gjithë shqiptarëve të Kosovës duhet të jetë që ky problem dhe kjo tragjedi të bëhet e njohur në botën e jashtme, sepse vetëm kur bëhet i njohur në një masë sa më e gjërë edhe mund të merret një qëndrim real e i drejtë i botës ndaj çështjes së Kosovës. Deri tash së voni Perëndimi ka qenë e zënë me problemin e bashkimit, me problemet ekonomike, pastaj me frikën që kanë gjermanët nga një valë eventuale e refugjatëve që do të vinin nga Bashkimi Sovjetik. Ajo do të mund të ishte një valë prej miliona refugjatësh! Pra, Kosova është e vogël por ka probleme të shumta. Ato probleme duhet të bëhen të njohura patjetër.

Përsa i përket përshtypjes që më kërkoni t'ua them, nuk mund të them se ishte ndonjë përshtypje e mirë ajo me të cilën u ballafaqova para dy ditësh këtu në Prishtinë. Ajo ishte diçka e frikshme. Isha në dhomën time në hotel duke fjetur, kur përnjëherë u dëgjuan armët automatike, bombat... Kisha përshtypjen se ndodhesha në Bejrut ose ne Bagdat. Mendova menjëherë se kishte ndodhur ndonjë masakrim. Pastaj kanë filluar brohoritje të egra, të frikshme... Aso brohoritjesh nuk kam dëgjuar ndonjëherë. Të nesërmen e mora vesh se ishte manifestimi i gëzimit (!) për një ndeshje futbollit nga ana e serbëve të këtushëm dhe se kjo ishte një gjë e zakonshme për rrethanat e Kosovës. Për mua kjo nuk ishte sjellje normale. E kuptoj se nga tifosët ka ekstremistë kudo, por një masë të atillë nuk besoj të ketë gjetkë.

Bisedën e zhvilloi Shaip Beqiri.

[botuar në / published in: gazeta *Zëri*, Prishtina, 29 qershor/June 1991, p. 28-30.]